



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE SHKODËR**

**NOTER ARBEN S. KOPLIKU
ADRESA Bulevardi "Zog I", pallati 1.
TEL: +355684031111**



VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISË SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Nr. repertori: 2422

Nr. koleksioni: 1253

Shkoder më 15/09/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

***Akti noterial përbëhet nga 5 fletë**



A2022040400133974828



A2022040400133974828

VENDIM

PER LËSHIMIN E DËSHMISË SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Sot, më 15 Shtator 2022 (dymije e njezet e dy) ditën e enjte, para meje, **noter Arben Salim KOPLIKU**, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Shkodër, me seli në Shkoder, Bulevardi "Zog I", pallati 1, u paraqit personalisht dhe vullnetarisht :

Kërkues : Jozef ÇAUSHI, atësia Viktor, amësia Pranvera, shtetas shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në Shkodër, me adresë Kupe Danja 03310240; Nd. 15; H. 1; 4001; Shkodër, lindur më 17/06/1992, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036311024 dhe nr. personal J20617117W .

Objekti : Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin **Viktor Rrok Çausi**.

Baza ligjore : Nenet 316, 317, 318, 348, 360, 361 e vijues i ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "*Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë*", me ndryshimet, neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "*Për Noterinë*".

Pasi administrova në tërësi provat shkresore të paraqitura nga kërkuesi dhe dëgjova pretendimet e tij, Unë Noteri kryesisht, bazuar në nenin 111, 113 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "*Për Noterinë*", përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës, verifikova dhe konstatova se kjo çështje hyn në kompetencën e Shërbimit Noterial, të Degës Vendore Shkoder, përkatësisht noter Arben Salim Kopliku, me zyrë Noterie në Shkoder, Bulevardi "Zog I", pallati 1, territor mbi të cilën shtrin kompetencën kjo zyrë për shqyrtimin e kësaj kërkesë.

Në këto kushte,

VËREJ SE:

Kërkuesi Jozef Çausi, ka kërkuar lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për babain e tij te ndjere , trashëgimlënësin Viktor Rrok Çausi.

Ai, bashkë me kërkesën, ka paraqitur :

1. Çertifikaten e vdekjes se trashegimlennesit Viktor Rrok Çausi
2. Çertifikaten e martesës se tij.
3. Çertifikatat e trungut te tij familjar.
4. Çertifikatat vetjake/personale te trashegimtareve te tij ligjore, bashke-shortes dhe dy femijeve te tij/tyre.



Unë Arben Salim Kopliku, në cilësinë e noterit të Njesisë Vendore të Qarkut Shkodër, në bazë të nenit 336 të KC, i ndryshuar me nenin 4 ligjit Nr. 121/2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në bazë të nenit 318/2 i KC e nenit 348 të KC të ndryshuar, kam kompetencën juridiksionale dhe lëndore për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, pasi vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit Viktor Rrok Çausi, vertetohet të ketë qenë në Shkodër.

Nga shqyrtimi akteve që i bashkangjiten kërkesës, arrihet në përfundimin se kërkuesi Jozef Çausi si djali i trashëgimlënësit, dhe një nga trashëgimtarët e tij ligjore, legjitimohet në kërkimin para noterit, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësin Viktor Rrok Çausi.

Keshtu, sipas :

1. Çertifikates se vdekjes (nga Akti) nr. serie 017724922 datë 12 Shtator 2022, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile e Njesise Administrative nr. 332 të Bashkisë Shkodër, sipas Aktit të vdekjes nr. 623 datë 12 Shtator 2022, vertetohet se me 5 Shtator 2022, ka vdekur trashëgimlënësi Viktor Çausi, i biri i Rrok dhe Leze Çausi, i datelindjes 3 Tetor 1963, lind në Prekaz, Gllokovc, Kosova, me gjendje familjare i martuar, shtetesi shqiptare e nr. vetjak G31003129D.

2. Çertifikates familjare (te trungut familjare, me dy flete), nr. serie 017791481 dhe nr. 017791480 datë 12 Shtator 2022, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile 340, Njesia Administrative e Bashkisë Berdise 340, Bashkia Shkodër sipas Regjistrit themeltar të vitit 1974 Trush nr. 19/339, vertetohet se trashëgimlënësi Viktor Çausi, është me gjendje familjare beqar.....

Shenim: Pashuk vdeke 13.12.1979; Lulë vdek me 10.10.77 (Ketu është trangu familjar i k/familjarit Pashuk Çausi, sipas regjistrit Trush, nr. 19/339, të vitit 1974).

3. Çertifikates se martesës (nga akti), nr. serie 017530017 datë 12 Shtator 2022, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile (Arkiva) Shkodër, Qarku Shkodër, Rrethi Shkodër, sipas Librit/Akteve të Martesës Shkodër të vitit 1989, vertetohet se trashëgimlënësi Viktor Rrok Çausi, është martuar me shtetasen Pranvera Qemal Kafexhija/Çausi, sipas Aktit nr. 92 datë 13 Shkurt 1989, dhe para kësaj martese, të dy kanë qenë beqarë.

4. Çertifikates familjare (te trungut familjare), nr. serie 016669401 datë 12 Shtator 2022, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile 338, Njesia Administrative Bushat, Bashkia Vau- Dejes, sipas Regjistrit themeltar të vitit 1974, Konaj, nr. 55/56, vertetohet se trashëgimlënësi Viktor Rrok Çausi, është i martuar me shtetasen Pranvera Qemal Çausi, dhe nga kjo martese, sipas kësaj çertifikate (në këtë periudhë), nuk kanë fëmijë.

Shenim: Rrok vdek me datë 27.12.2007; Viktor, David, valentin, Ardian ndasi familjare. Ferdinand martuar me shtetase të huaj me datë 26.04.2005.

5. Çertifikates familjare (te trungut familjare), nr. serie 009875555 datë 12 Shtator 2022, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile 332, Njesia Administrative



A20220404001339*4828

Shkoder 332 e Bashkise Shkoder, sipas themeltar te vitit 1974 nr. 66e/1378, vertetohet se trashegimlenesi Viktor Rrok Çausi, eshte i martuar me shtetasen Pranvera Qemal Çausi, dhe nga kjo martese, u kane lindur dy femije, te quajturit : 1. Jozef Viktor Çausi dhe 2. Andreina Viktor Çausi.

Shenim: Viktor, Pranvera vendosje ne Qyt. Shkoder nga ZGJC Berdise dt. 12.04.1991.

ZGJC Shkoder Vendim nr. 23 date 02.04.2007, Viktor ka bere korigjim te dates se lindjes nga 04 ne 03; Vend. Gjyk. Shko nr. 2913 dt. 21.12.2006, Korigjim i vendlindjes nga Barbullush, Shkoder ne Prekaz, Gllokovc, Kosove.

6. Çertifikates familjare (te trungut familjare), nr. serie 009875553 date 12 Shtator 2022, leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile 332, Njesia Administrative 332 Shkoder, Bashkia Shkoder, sipas Regjistrit Kombetar te Gjendjes Civile te vitit 2010, vertetohet se trashegimlenesi Viktor Rrok Çausi, eshte i martuar me shtetasen Pranvera Qemal Çausi, dhe nga kjo martese, u kane lindur dy femije, te quajturit : 1. Jozef Viktor Çausi dhe 2. Andreina Viktor Çausi...

Shenim :Perberja familjare date 04.09.2022.

7. Çertifikates familjare nr. serie 009875554 date 12 Shtator 2022, leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile 332, Njesia Administrative 332 Shkoder, Bashkia Shkoder, sipas Regjistrit Kombetar te Gjendjes Civile te vitit 2010, vertetohet se familja e trashegimlenesit Viktor Rrok Çausi, sipas kesaj certificate e kesaj periudhe, eshte e perbere nga bashkeshortja e tij Pranvera Qemal Çausi dhe dy femijet e tyre, te quajturit : 1. Jozef Viktor Çausi dhe 2. Andreina Viktor Çausi

Shenim : Perberja familjare date 12.09.2022.

Nuk vertetohet qe trashëgimlënësi Viktor Rrok Çausi të kenë disponuar pasurinë e tij me testament, sipas dokumentit te leshuar nga Regjistri Noterial Shqiptar, Dhoma Kombetare e Notereve, kerkese nr. 855- 476 date 15 Shtator 2022.

Prandaj sipas nenit 317 të K. Civil, për caktimin e rrethit të trashëgimtarëve të trashëgimlënësit Viktor Rrok Çausi, do te zbatohet trashëgimia me ligj.

Permbajtur nenit 361 te Kodit Civil në fuqi, në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit Viktor Rrok Çausi, pra date 5 Shtator 2022 (Kodi Civil i tashem), paragrafi i parë i tij, ku parashikohen trashëgimtarët ligjore të radhës se parë, me formulimin: «Në radhë te parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta».

Keshtu, me vdekjen e tij, çelet trashëgimia ligjore, duke u caktuar rrethi i trashëgimtareve ligjore te radhes se pare të trashëgimlënësit Viktor Rrok Çausi, qe jane bashkeshortja dhe dy femijet e tij, te quajturit :



A2022040400133974828

1. **Pranvera Çausi**, e bija e Qemal dhe e Melihat Kafexhija, e datelindjes 15 Korrik 1964, lindur e banuese ne Shkoder, me gjendje familjare e ve, me shtetesi shqiptare e nr vetjak G45715218C.....
2. **Jozef Çausi**, i biri i Viktor dhe Pranvera Çausi, i datelindjes 17 Qershor 1992, lindur e banues ne Shkoder, me gjendje familjare beqar, me shtetesi shqiptare e nr. vetjak J20617117W.
3. **Andreina Çausi**, e bija e Viktor dhe e Pranvera Çausi, e datelindjes 13 Nentor 1995, lindur e banuese ne Shkoder, me gjendje familjare beqare, me shtetesi shqiptare e nr. vetjak J56113079I,

të cilet trashëgojnë secili nga **1/3 pjesë** (nje te treten) të pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit Viktor Rrok Çausi, si dhe të detyrimeve, ne te njejtin raport e deri në vlerën e plotë të pasurisë trashëgimore që trashëgimlënësi mund të ketë lënë.....

Nga të gjitha çertifikatat personale se trashëgimtareve, vertetohet se ato kanë qenë gjallë në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit, kur është çelur trashëgimia, si dhe janë edhe sot gjallë, në çastin e lëshimit te kesaj deshmi trashigimie.

Nga aktet që i bashkangjiten kërkesës, dhe aktët që ndodhen pranë kësaj Zyre, si ma sipër, nuk vertetohet se :

1. Ndonjë nga trashëgimtarët e mësipërme të ketë hequr dorë nga trashëgimia, të jetë shpallur i/e padenjë për të trashëguar me vendim gjykate, ose të jetë përjashtuar nga trashëgimia e trashëgimlënësit Viktor Rrok Çausi....
2. Nuk vertetohet që trashëgimlënësi të kete pasur martesë të mëparshme, as të kenë pasur fëmijë të tjerë, jashtë martese, a të birësuar.

Kërkuesja deklaron se nuk ka trashëgimtarë të tjerë ligjore, përveç atyre të pasqyruar në trungun/gjet familjare dhe në çertifikatat vetjake/personale të depozituara prej saj, po ashtu dhe në aktet që ndodhen pranë kësaj zyre, nuk vertetohet një gje e tillë.

PËR KËTO ARSYE

Une, noter Arben Salim Kopliku, mbeshtetur në nenin 348 te KC, i ndryshuar,

V E N D O S A

- I. Pranimin e kerkeses.
- II. **Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësit Viktor Rrok Çausi**, duke caktuar si trashëgimtarë ligjore të radhës së parë, bashkeshorten dhe dy femijet e tij, te quajturit :
 1. **Pranvera Qemal Çausi, e shoqja.**
 2. **Jozef Viktor Çausi, i biri.**



3. Andreina Viktor Çausi, e bija,
të cilet e trashëgojnë trashëgimlënësin Viktor Rrok Çausi, secili nga 1/3
pjese (nje te treten pjese) të pasurisë se tij trashëgimore, si dhe përgjigjen për
detyrimet e tij trashëgimore, ne te njejtin raport e deri në vlerën e plotë të
pasurisë që trashëgimlënësi mund të ketë lënë.....

III. Për të gjitha pasuritë e trashëgimlënësit Viktor Rrok Çausi, që do te
vertetohet të jenë përfituar gjatë periudhës së martesës dhe që ndodhen të
regjistruara pranë ZRPP, ASHK, në emrin e trashëgimlënësit Viktor Rrok
Çausi, regjistrimi i pjeseve takuese të trashëgimise ligjore të shpallura më
sipër, do të bëhet pasi të jetë zbritur më parë ½ pjesë e prezumuar e
bashkepronësisë të bashkeshortes pasjetuese **Pranvera Qemal Çausi,**
prandaj kesaj deshmie i bashkengjitet certifikata e martesës se paleve.

IV. Mbeshtetur ne nenin 112 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”,
kerkuesi, brenda 30 (tridhjetë) diteve, duhet te depozitoje ne institucionin
pergjegjes per rregjistrimin e pasurive (ne ASHK, Shkoder, QKB, DPSHTR
/Drejtoria e Transportit Rrugor, a ku mund te kete pasuri te regjistruara), nga
nje kopje te kesaj deshmie te trashëgimise, gje te cilen ai e mori persiper, pasi
ne te kunderten, me kalimin e ketij afati nje mujot, ka gjobe, sipas ligjit per kte
qellim.

V. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit
Gjyqesor Shkoder, në zbatim të nenit 138 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”
dhe sipas nenit 46 të Kodit të Procedurës Civile, sipas rregullave për gjykimin
e mosmarëveshjeve administrative.

VI. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të
dhënave personale”, unë, noteri, deklaroj se do ruaj e përpunoj të dhënat
personale të subjekteve të kësaj dëshmie, në mënyrë të drejtë dhe të
ligjshme.

VII. Dokumenti përmban pese faqe, hartohet në pese kopje të njëjta, dhe
leshohet në Shkoder, sot më 15 Shtator 2022 (dymije e njezet e dy), nga unë,
A. S. Kopliku, noter.....

Arben Salim KOPLIKU
NOTER

